**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË**
**ZYRA ARSIMORE LUSHNJE**

# TESTI I OLIMPIADËS KOMBËTARE TË GJUHËS SHQIPE DHE LETËRSISË FAZA E I KLASA E XI

*Dt. 18.12.2018*

Te dashur Nxenes!
Lutemi qe ne interpretimin tuaj artistiko- letrar ju te kenaqni Egon estetike mbi bukurine e fjales se autoreve te medhenj apo edhe bulezat e emocioneve tuaja qe ju burojne prej shpirtit.
Shijojeni dhe suksese ne hamendesimin tuaj letrar.!

**Interpretimi nr.1** ( 10 pike,5 pike raporti me autorin, 5 pike raporti me vetveten)

Ka thene J. Gete:

Gjithmone me kane quajtur si te privilegjuar nga lumturia...

Ne thelb ,jeta ime ka qene vetem mund dhe pune.Mund te them fare mire se ne 75 vitet e mia nuk kampasur me shume se kater jave lumturie te vertete.

Perjetesisht, guri sizifian rrezohej dhe mua me duhej ta ngrija serish.

**Interpretimi nr.2** ( 10 pike, 5 pike raporti me autorin, 5 pike raporti me vetveten)

Ka thene Hygoi:

Populli hesht.Une do te jem perkthyesi i palodhur i kesaj heshtjeje, do te flas per memecet. Do t,ju flas te medhenjve per te vegjlit dhe te fuqishmeve per te dobetit.Ky eshte qellimi i jetes sime. Me eshte ngarkuar nje mision.Do te flas per te gjithe njerezit e heshtur dhe te deshperuar.. Do te shpreh belbezimin e tyre te mbytur; do te shfrej qarjet dhe renkimet e tyre; do te perkthej ne gjuhen njerezore murmurimat e turbullta te turmes; vajtimet e shprehura keq, zerat e pakuptueshem, tere ato britma shtazarake qe vuajtja dhe padituria nxjerrin nga goja e njerezve.

Ulerima e njerezve eshte e mbytur si ulerima e eres.Ata kelthasin , po askush nuk i kupton, sepse te ulerish eshte njelloj si te heshtesh, e te heshtesh do te thote te jesh i carmatosur.Njerezit jane carmatosur me dhune e therrasin per ndihme. E une do t'u vete per ndihme. Do te jem demaskues.Do te jem zeri i popullit. Raca njerezore eshte ne goje dhe une jam klithma e saj. Fale meje, gjithcka do te behet e kuptueshme. E kjo ka per te qene nje veper e madhe.

**Interpretim nr.3** ( 10pike, 5 pike ne raport me autorin, 5 pike ne raport me vetven)

Do te shtrihem,
Te venitem
Si kandili ,kur s'ka vaj,
Balt' e pluhur
Do te behem
Te me shkelnje kemb' e saj,

E te prehem
Duke puthur
Ate kembe pasandaj.

**Ese argumentuese** ( 20 pike,5pike stili,5pike drejtshkrimi,5 pike struktura, 5 pike tema).

Tema:

A mendoni se bukuria fizike dhe shpirterore eshte nje binom qe mund erresiren mesjetare te te gjitha koherave?